

Në bazë të Nenit 12 dhe Neni 17 të Ligjit për vetëqeverisje lokale Nr.03/L- 040 dhe Nenit 2 dhe 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit me 01. Nr. 569/1 i datës 16.12.2010, dhe pas Raportit të Komisionit MMPH-MAPL me Nr. 028-337/26 të datës 31.03.2016, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur me 28 Prill 2016 merr këtë :


V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e Kompanisë NTP,, Vëllezërit Morina “ SHPK për lëshimin e **Pëlqimit të Përkohshëm për 1 vit** për shfrytëzimin e ngastrave kadastra le 777, 778 dhe 779 Fleta poseduese Nr. 478, në vendin e quajtur Rakita vija - rakita zona kadastrale Xërxe , për prodhimin e betonit dhe seperacionit të rërës .
- II. Me qëllim të evitimit të pengesave juridike , zhvillimit të rregullte të procedurës për licencimin pranë institucioneve të Kosovës (KPMM , MMPH, MBPZHR) e konsiderojmë si të arsyeshëm që ky propozim të aprovohet nga Kuvendi i Komunës.
- III. Ngastrat kadastrale në të cilët NTP,, Vëllezërit Morina “ SHPK do të aplikoj në institucionet e Republikës së Kosovës për licencim është pronë private e z. Lulzim Morina respektivisht pronarit të vetë ngastrës kadastra le **dhe është zonë e mbrojtur e përcaktuar me Vendimin 01Nr. 352/13 të datës 09.04.1986 të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit .**
- IV. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm , Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Inspektim të kujdesen për implementimin e këtij Vendimit.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas pranimit nga NJAD (Njësia për Administrimin e dokumenteve pranë MAPL-së) në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Nr. 03/L-040 si dhe nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr. 01.2016 për shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe pas shpalljes në tabelën publike dhe në ueb faqen zyrtare të Komunës .

01 Nr. 1416

Rahovec, 28. 04. 2016

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT



-III- Nr. i prot. 1416 Më 28.04 2016
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC



Kryesuesi i Kuvendit

Nahit Elshani